



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

**VENDIM**

**Nr. 93/2017**

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIKËS  
DHE KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË PERSONELIT TË KOMISIONIT  
TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës, si dhe të neneve 18, pika 1, dhe 29 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

I. Miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

II. Organika dhe klasifikimi i pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

III. Struktura organizative e personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është sipas lidhjes nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I**

**Gramoz RUÇI**

Miratuar në datën 29.9.2017

**ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË KOMISIONIT  
TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

| <b>Funksioni organik</b>   | <b>Klasifikimi i pagës</b>                         | <b>Numri<br/>(2)</b> |
|--|--|----------------------|
| <b>I. KRYETAR</b>  | G3*  | 1                    |
| Sekretar   | Sekretar në kabinetin e<br>Kryetarit të Kuvendit** | 1                    |
| <b>II. KOMISIONERËT</b>  | G3*  | <b>(11)</b>          |
| <b>III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR</b>  |  | <b>(16)</b>          |
| Këshilltarë juristë  | 80% e pagës G3*                                    | 12                   |
| Këshilltarë ekonomistë   | 80% e pagës G3*                                    | 4                    |
| <b>IV. SEKRETAR I PËRGJITHSHËM</b>   | I-a  | 1                    |
| <b>V. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE<br/>DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE<br/>PUBLIKUN</b> |  | <b>(12)</b>          |
| Drejtor  | II-b   | 1                    |
| Specialist sekretarie gjyqësore  | IV-a   | 4                    |
| Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve  | IV-b   | 2                    |
| Përkthyes  | II-b   | 3                    |
| Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë  | III-a  | 1                    |
| Specialist pritje me popullin  | IV-b   | 1                    |
| <b>VI. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E<br/>SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE</b>                                |  | <b>(8)</b>           |
| Drejtor  | II-b   | 1                    |
| Specialist financë/buxhet  | III-b  | 1                    |
| Specialist i burimeve njerëzore  | III-b  | 1                    |
| Specialist IT  | III-b  | 1                    |
| Specialist protokoll/arkiv   | IV-b   | 1                    |
| Magaznier  | VII  | 1                    |
| Punonjës pastrimi  | III  | 1                    |
| Shofer   | V  | 1                    |
| <b>Gjithsej</b>  |  | <b>50</b>            |

Shënim:

\*Sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

\*\*Kategoria e pagës për sekretarin e Kryetarit është sipas VKM nr. 187/2017.